



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.9/2 prot.,

Datë 04.01.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “*Rikonstruktion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës*” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
- Ankimues:** Operatori Ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, me NIPT: K71401004W.
Adresa: *Rruga “Adem Jashari”, Nd. 4, Hrja 10, Nj Bashkiake nr.5, Tiranë*
- Autoriteti Kontraktor:** Posta Shqiptare sh.a.
Adresa: *Rr. “Reshit Çolloku”, Nr. 4 Tiranë*

Në datën 03.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë shkresore ankesa me nr. 9, protokolluar me datë 03.01.2024 e operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “*Rikonstruktion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës*” me fond

limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 9 prot., datë 03.01.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të ofertës së paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush plotësisht kriteret teknike për kualifikim dhe konkretisht:

Nuk plotëson; Pikën e Kapacitetit teknik, konkretisht pika 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme: -DSIK – Certificate e sigurimit Industrial (CSI)

*Nuk plotëson; Pikën e Kapacitetit teknik, konkretisht pika 2.3.3/b, Operatorët ekonomikë duhet të Paraqesë dëshmi për fuqinë puntore të operatorit ekonomik, b, OE duhet të disponojë punonjës të spëcializuar/kualifikuar, si më poshtë: *duy teknik ndërtimi . Për plotesimin e këtij kriteri ka deklaruar se do të mbështetet me kapacitet teknik nga shoqëria “ALBTIEFBAU” shpk, Nipt: J66703049C, por referuar dokumentave të tenderit për këtë procedurë, Seksioni 2, pika 2. 16, Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera, nuk pranohet. Pra nuk lejohet Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera.**

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”, rezulton që oferta e operatorit ekonomiknuk Skualifikohet

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.01.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri